



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.188 dt.24.12.1998

**PER  
FINANCIMIN E FONDIT PER KONCERTIN VARIETE FONDACIONIT  
SHQIPTAR TE TE DREJTAVE TE PAAFTESISË**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës për dhënien e fondit prej 25 mijë lekë (njëzetepesëmijë) për Koncertin Variete që do të bëhet me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Paaftësisë nga Fondacioni Shqiptar i të Drejtave të Paaftësisë në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, mbështetur në ligjin Nr.7572, neni.45, pika.16

**VENDOSI**

1. Të financojë shumën prej 25.000(njëzetepesëmijë) lekë për Koncertin Variete, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Paaftësisë.
2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**